



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 30, datë 06.03.2024

**PËR MIRATIMIN E NDREQJES SË GABIMIT ME KARAKTER MATERIAL NË PASQYRËN NR.4, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 195, DATË 22.12.2023, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024 - 2026 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**



1. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material, pasqyra nr. 4, “Plani i shpenzimeve kapitale nga burimet e veta për vitet 2024-2026” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, përsa i përket korrigjimit të emërtimeve të projekteve si më poshtë vijon:
  - 1.1. Emërtimi i projektit: “Blerje automjet autobot tek gabine me kapacitet 1000 litra” zëvendësohet me emërtimin: “Blerje kamion me çisternë për transport lëndë të ndryshme (ujë) për Drejtorinë e MZSH-së”.

1.2. Emërtimi i projektit: “Blerje automjet zjarrfikës dopio kabine me kapacitet 5000 litra ujë, 500 litra shkume dhe pajisjet profesionale të një mjetei zjarrfikës për 6 persona” zëvendësohet me emërtimin : “Blerje automjet zjarrfikës për Drejtorinë e MZSH-së”.

1.3. Emërtimi i projektit: “Mobilim me elemet urban të hapësirave publike dhe sinjalistike”, zëvendësohet me emërtimin: “Rikualifikimi urban i hapësirave publike”.

1.4. Emërtimi i projektit: “Materiale për sheshet e parkimeve në qytetin e Durrësit”, zëvendësohet me emërtimin: “Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

#### KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 07.03.2024**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 162 Prot.  
16

Durrës, më 18.07.2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.30 datë 06.03.2024 “Për miratimin e ndreqjes së gabimit me karakter material në pasqyrën nr.4, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.195, datë 22.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024 - 2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë durrës për vitin 2024”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

